

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË – DEGA NË PODUJEVË – Departamenti i përgjithshëm – divizioni civil: me gjyqtarin Bujar Muzaqi, dhe Sekretaren juridike Mirvete Ahmeti, në çështjen juridiko civile të Paditësit N.A. me vendbanim në Rr. “...”, objekti ..., Hyrja enr....., A., Komuna P., kundër të Paditurës Komuna e Podujevës, në çështjen kontestimore për kthim në punë, pas mbajtjes së seancës së shqyrtimit kryesor, në prani të paditësit dhe të përfaqësuesit të autorizuar të të paditurës me datë 07.10.2013 morri këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHET si e pabazuar kërkesëpadia e paditësit N.A. nga P. për konstatimin se Paditësi e ka cilësinë e punëtorit me kohë të pacaktuar të e Paditura Komuna e Podujevës në punën dhe detyrën e punës së ofiqarit, dhe kthimin e Paditësit në punët që ka kryer më parë me të gjitha të drejtat nga puna të e Paditura Komuna e Podujevës.

Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

A r s y e t i m

Paditësi në padi dhe në seancat gjyqësore të mbajtur pranë kësaj gjykate, ndër të tjera ka deklaruar se unë kam qenë në punë tek e paditura në punët dhe detyrat e punës së Ofiqarit në zyrën e vendit në fshatin L. i P., Komuna e Podujevës, po ashtu ka deklaruar se mbetet pranë të gjitha kërkesave të deklaruara pranë kësaj gjykate, në raport me të paditurën.

Ndërsa në seancën e shqyrtimit kryesor të mbajtur me datë 07.10.2013, paditësi ndër të tjera ka deklaruar se mbesë në tërësi pranë padisë për kthim në vend pune, njëherit të konstatohet se e ka cilësinë e punëtorit me kohë të pacaktuar të e paditura, në punët dhe detyrat e punës së ofiqarit me të gjitha të drejtat dhe obligimet, po ashtu në bazë të shkresave të lëndës i propozon gjykatës që padinë dhe kërkesëpadinë ta aprovoi në tërësi si të bazuar. Shpenzimet e procedurës nuk i ka kërkuar.

E paditura në përgjigjen në padi ndër të tjera ka deklaruar se e kundërshton në tërësi padinë e paditësit, po ashtu ka deklaruar se në bazë të Rregullores mbi Vetëqeverisjen e Komunave të Kosovës nr.2000/45 janë themeluar Komunitet sipas së cilës Komuna e tashme nuk është suksesore juridike e ish – Komunës dhe në bazë të kësaj Rregulloreje po as edhe me ndonjë dispozitë ligjore nuk është përcaktuar se e njëjta është e obliguar që t'i pranojë në punë punëtorët e ish- Komunës ndërsa Paditësi me të Paditurën asnjëherë nuk ka krijuar raport juridik civil të mardhënies së punës (me vendim apo Kontratë).

Ndërsa në seancën e shqyrtimit kryesor të mbajtur me datë 07.10.2013 nëpërmes përfaqësuesit të autorizuar të saj F.R. ka deklaruar se edhe më tutje mbesim pranë thënieve si në përgjigje në padi dhe thënieve të thëna në seancat e mbajtura pranë kësaj gjykate. Shpenzimet e procedurës nuk i ka kërkuar.

Gjykata bazuar në vërejtjet e gjykatës se Qarkut në Prishtinë AC.nr.193/08 dt.29.10.2008, si dhe bazuar në nenin 199 të ligjit nr.03/1-006 për procedurën Kontestimore, i mori të gjitha vërejtjet dhe veprimet në bazë të Aktvendimit të Gjykatës së Qarkut në Prishtinë Ac.nr.193/2008, si duke i dëgjuar në cilësi të palës Paditësin, si dhe përfaqësuesin e autorizuar të të paditurës, duke kërkuar nga pala paditëse prova se në çfarë mënyre i është dorëzuar paga mujore, po ashtu ka kërkuar nga përfaqësuesi i autorizuar i të paditurës të deklarohet se a është pranuar ndonjë punëtor si dhe i njëjti vend i punës a ekziston ende.

Në seancën e shqyrtimit kryesor të mbajtur me datë 07.10.2013 u administruan provat më të rëndësishme për vërtetim të plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike siç janë : Aktvendimi me nr.01-111-521 i dt.10.04.1973, Aktvendimi me nr.201-38/73-08 i dt.23.08.1973, u bë leximi i njoftimit për kthim në vendin e punës i paditësit drejtuar Kuvendit Komunal Podujevë i dt.25.11.1999, kërkesa e paraqitur nga paditësi më dt.03.04.2001 pranë Kuvendit Komunal Podujevë për rikthim të statusit të punëtorit me nr.11-218 dt.08.01.2001, parashtrës E.nr.383/2011 e dt.14.06.2013, Aktvendimi i Gjykatës së Qarkut në Prishtinë Ac. nr.638/1992 i dt.22.10.1992, procesverbal i dt.11.09.2013 në të cilin procesverbal paditësi dhe përfaqësuesi i të paditurës janë dëgjuar në cilësi të palëve.

Gjykata pasi i analizoj provat e administruara në kuptim të nenit 8 të ligjit nr.03/1-006 për procedurën Kontestimore gjeti se kërkesëpapia e paditësit është e pabazuar për këto arsye.

Sa i përket konstatimit se paditësi e ka cilësinë e punëtorit me kohë të pacaktuar të e Paditura në punët dhe detyrat e punës së ofiqarit në Fshatin L. të P., Komuna e Podujevës, në seancën e dt. 14.08.2013 përfaqësuesi i autorizuar i të Paditurës ka deklaruar se Komuna ka shpallur Konkurs për vendin Ofiqar në Fshatin L. të P., por në bazë të këtij Konkursi në vendin e punës ofiqar në Fshatin L. i P. është pranuar punëtori Xh.M..

Ndërsa lidhur me këtë deklaram nga ana e përfaqësuesit të autorizuar të paditurës, paditësi N. A. në po të njëjtën seancë të dt. 14.08.2013 nder të tjera ka deklaruar se : “ **... në momentin kur në vendin e punës si ofiqar në Fshatin L. të P. në Komunen e Podujevës është pranuar punëtori tjetër e jo unë në Konkursin e shpallur nga Komuna a është dashtë që Komuna të më njoftoj mua se pse unë nuk jam pranuar në punë, e është pranuar punëtori tjetër, po ashtu në seancën e shqyrtimit kryesor të dt.07.10.2013, paditësi N. A. ndër të tjera ka deklaruar se : “ ... Sa i përket konkursit të shpallur për këtë vend të punës po ka ekzistue ky konkurs dhe unë kam aplikue për këtë vend të punës, ndërsa a ka aplikue edhe Xh. M. nuk jam në dijeni”.**

Në bazë të deklarimeve të thëna në seancën e shqyrtimit kryesor palëve ndërgjyqëse nuk është kontestuese se ka ekzistue Konkursi për vendin e punës Ofiqar në Fshatin L. i P., Komuna e Podujevës, meqë ka ekzistuar Konkursi për vendin e punës, në këtë periudhe kohore në Republikën e Kosovës ka qenë në fuqi Rregullorja nr.200/45, në të cilën Rregullore në nenin 2 par.4 thuhet se “ **Çdo Komunë e ka statusin e vet juridik, të drejtën për të poseduar dhe administruar pronën, mundësinë për të ushtruar padi dhe për të qenë i Paditur në gjykata, të drejtën për të lidhure kontratë dhe të drejtën për të merre punëtorë në punë”**

Nga dispozita e cituar ligjore rezulton se komuna e ka pas të drejtën për të marr punëtorë në punë në bazë të Konkursit të shpallur.

Në bazë të kësaj e duke u bazuar në deklaramet e përfaqësuesit të autorizuar të të Paditurës në çoftë se Paditësi ka vërejt ndonjë parregullsi në Konkursin e shpallur nga Komuna e Podujevës ka pas mundësi të paraqes padi për anulimin e Konkursit të shpallur për pozitën e Ofiqarit në Fshatin L. i P., Komuna e Podujevës.

Ndërsa lidhure me deklaramet e Paditësit të thëna në Padi se ai ka punuar te e Paditura me shume se 30 vite në vendin e punës Ofiqar në Fshatin L. i P., Komuna e Podujevës, Gjykata konstaton se në bazë të Rregullores nr.200/45 të Republikës së Kosovës, përgjegjësit e Komunës janë paraparë në nenin 3 të kësaj Rregullores, dhe nuk ekziston sukcesion juridik mes ish Komunës dhe Institucioneve të tyre, dhe atyre të themeluara me këtë Rregullore.

Rrjedhimisht, meqenëse nga provat e administruara dëgjimit të palës paditëse, dhe përfaqësuesit të autorizuar të palës së paditur, konstatimit të gjendjes faktike, rezulton se Paditësi nuk e ka cilësinë e punëtorit me kohë të pacaktuar te e paditura në detyrat e punës së ofiqarit me të gjitha të drejtat, po ashtu në bazë të nenit 2 par.4 të Rregullores nr.200/45 Komuna e ka statusin e vet juridik, dhe të drejtën për të marrë punëtorë në punë në bazë të Konkursit të shpallur.

Lidhur me shpenzimet procedurale, Gjykata vendosi konform dispozitës së nenit 450 të Ligjit nr.03.L-006 për procedurën kontestimore, që secila palë i

bartë shpenzimet e veta procedurale te shkaktuara me veprimet e veta procedurale.

Nga sa u parashtrua me lartë u vendos si ne dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË DEGA NË PODUJEVË
Departamenti i përgjithshëm- divizioni civil
C.nr.880/08 datë 07.10.2013

Gjyqtari,
Bujar Muzaqi

KËSHILLA JURIDIKE : Kundër këtij Aktgjykimi lejohet ankesa në afatin prej 7 ditësh, nga dita e marrjes së aktgjykimit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë e nëpërmes kësaj Gjykate.